



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## **KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Nr. 02-060/01-0034085/26 dt. 12.06.2026**

**Mitrovicë**

### **NJOFTIM**

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.3 të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës; nenin 61, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; në nenin 25 dhe 26 të Statutit të Komunës; nenit 17, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenit 19, nenit 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 Për Administratë të Hapur në Komuna; bazuar në Rregulloren Komunale për Transparencë, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Safet Kamberi në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim, ORGANIZON:

### **KONSULTIM PUBLIK**

#### **PËR**

#### **KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2027-2029**

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultimin Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029.

Konsultimi publik do të mbahet të **premtën** më dt. **19.06.2026** në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora **10:00**.

Njëkohësisht të gjithë qytetarët dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 15 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i bëjnë përmes ueb faqes së Komunës <https://mitroviceejugut.rks-gov.net/> te Udhëheqësi i Sekretarisë së Kuvendit z. Nazmi Jashari në e-mailin: [nazmi.jashari@rks-gov.net](mailto:nazmi.jashari@rks-gov.net), ose drejtpërdrejtë në Zyrën pritëse dhe Zyrën Nr. 60 të Sekretarisë së Kuvendit të Komunës, ku edhe mund të merret Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029.

Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029 po ashtu mund ta gjeni të publikuar ne ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke klikuar linkun: <https://mitroviceejugut.rks-gov.net/dokumentet-per-konsultim-publik/>.

**Mitrovicë**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Safet KAMBERI**  
